



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE



Mjetet Efektive Juridike në Drejtësinë Administrative

Prishtinë, shtator 2017

Programi Kërko Drejtësi është i financuar nga Departamenti Amerikan i Shteti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL dhe implementuar nga National Center for State Courts për të mbështetur një zhvillim të fuqishëm të kërkesën për drejtësi në Kosovë të bazuar në dëshmi. Nëpërmjet programit Kërko Drejtësi, NCSC është duke mobilizuar partnerët e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të vepruar si agjentë të ndryshimit duke nxitur llogaridhënien, transparencën dhe integritetin në sektorin e drejtësisë.

Ky raport është bërë i mundur me mbështetje nga Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL përmes programit Kërko Drejtësi. Mendimet, të gjetura, dhe konkludimet apo rekomandimet në këtë raport i përkasin autorit dhe nuk paraqesin mendimet e Departamentit Amerikan të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL ose National Center for State Courts.

Autorë: Ehat Miftaraj and Betim Musliu

Hulumtimi është mbështetur nga Fjorda Vllasolli dhe ekipi i hulumtuesve të terrenit: Kaltrina Ajvazi, Sabina Pergega, Suzana Manaj, Leotrim Bytyçi, Martin Komani, Albulena Mujaj Bajraktari, Rita Gacaferi dhe Erestina Buja.

RRETH IKD-së

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

Kontakt

Adresa: Rr. Rrustem Statovci, Hyrja 1, Nr.1, 10000, Prishtinë, Kosovë

email: info@kli-ks.org

web: www.kli-ks.org

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

PËRMBAJTJA

I.	Hyrje	4
II.	Metodologjia	5
	a) Punë përgatitore	5
	b) Mbledhja e të dhënave	5
III.	Korniza ligjore	6
	a) Drejtësia administrative në Kushtetutën dhe Ligjin e Kosovës	7
	b) Mjetet Efektive Juridike: Konventat Ndërkombëtare dhe zbatimi në praktikë.....	9
IV.	Rezultatet dhe të gjeturat.....	10
	a) Struktura e Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë.....	10
	b) Të gjeturat nga monitorimi i seancave gjyqësore	12
	c) Intervista me palët e interesit	16
	1. Intervistat me gjyqtarë	16
	2. Intervista me palë.....	17
	3. Analiza e vendimeve të formës së prerë	17
V.	Konkluzionet.....	19
VI.	Rekomandimet	20

I. Hyrje

Drejtësia administrative është një fushë e rëndësishme sepse mbulon ligjshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve të qeverisë dhe institucioneve publike dhe shtetërore në lidhje me të drejtat e qytetarëve të Kosovës që ndikojnë direkt në jetën e tyre dhe realizimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe obligimet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës¹. Shoqëritë e qeverisura nga sundimi i ligjit kërkojnë mjete juridike efektive në mënyrë që qytetarët të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat që rrjedhin nga vendimet administrative të kundërshtuara dhe aktorët administrativë publikë. Kjo nënkupton përkushtimin ndaj parimit që institucionet e publikut dhe administratës shtetërore duhet të veprojnë në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara me ligj. Në mungesë të një sistemi efektiv të drejtësisë administrative, qytetarët e Kosovës janë në rrezik të vuajnë nga veprime të paligjshme dhe arbitrare të qeverisë në shkelje të të drejtave të tyre

Ky raport jep të dhëna objektive dhe subjektive në lidhje me praktikën aktuale gjyqësore në çështjet administrative dhe analizon nëse këto praktika përputhen me detyrimet që dalin nga ligji i zbatueshëm. Përmes këtij procesi analitik, IKD zbulon se si zbatohet drejtësia administrative në praktikë; të cilat autoritetet administrative krijojnë më shumë mosmarrëveshje ligjore dhe baza më e shpeshtë për mosmarrëveshje të tilla. IKD gjithashtu hedh dritë mbi funksionimin e autoriteteve administrative kur rastet janë kthyer për rigjykim, shkallën deri në të cilën zbatohen afatet ligjore nga paraqitësit e kërkesave dhe organet administrative, dhe në fund vendimet e marra nga gjykata.

Duke vepruar kështu, ky raport ofron informacion mbi Departamentin për Çështjet Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë (më tej Gjykata) në ofrimin e mjeteve adekuate juridike për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në drejtësinë administrative. Ne i ofrojmë të dhënat dhe analizat e paraqitura në këtë raport si bazë për një diskutim produktiv midis të gjithë aktorëve relevantë për të zgjidhur problemet ekzistuese në drejtësinë administrative në Kosovë.

¹ Neni 22 nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

II. Metodologjia

Për qëllimin e këtij raporti, IKD ka përdorur metoda empirike dhe doktrinare për të mbledhur dëshmitë e nevojshme për të ekspozuar shkeljen sistematike të së drejtës për një mjet efektiv juridik dhe një gjykim në kohë të arsyeshme. Metodologjia e IKD-së filloi me një analizë të kujdesshme të legjislacionit në fuqi në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtare. Më pas, KLI grumbulloi dhe analizoi statistikat vjetore të Gjykatës dhe më pas mblodhi provat e praktikës gjyqësore përmes procesit të monitorimit të 86 seancave gjyqësore që mbulonin 41 raste gjatë periudhës 1 shkurt 2017 deri më 30 prill 2017. Përveç analizimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare të 40 rasteve, IKD i plotësoi të dhënat e veta duke kryer 10 intervista me gjyqtarë që kryesonin në 41 rastet e monitoruara. Së fundi, IKD udhëhoqi një fokus grup të përbërë nga akterët kryesor të çështjeve administrative dhe palë të interesuara për të përfunduar dhe vërtetuar gjetjet në fjalë.

a) Punë përgatitore

Para mbledhjes së të dhënave të nevojshme për këtë raport, IKD ka zhvilluar takime me Kryetarin e Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Udhëheqësin e Departamentit Administrativ, për t'i informuar për qëllimin e projektit dhe për të kërkuar bashkëpunimin e tyre. IKD gjithashtu ka bërë kërkesë për qasje në dokumente publike në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (Nr. 03/L – 215).² Gjithashtu IKD ka analizuar raportet vjetore të KGJK-së që kanë të bëjnë me vitet 2014, 2015 dhe 2016 për të vënë në dukje gjendjen aktuale të Departamentit Administrativ. Duke përdorur këto raporte IKD ka llogaritur shkallën e spastrimit dhe kohën e zgjidhjes së rasteve administrative, duke përdorur treguesit e CEPJ me qëllim të tregimit të efikasitetit të Departamentit Administrativ. IKD gjithashtu grumbulloi statistika për raportin e parë tremujor nga Gjykata Themelore e Prishtinës. Ndërkohë, në përgatitje për monitorimin e procedurave gjyqësore, IKD hartoi një Doracak për Monitorimin e Drejtësisë Administrative (Manual) në Kosovë që përshkruan qëllimin e monitorimit, kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar dhe metodologjinë e raportimit. Manuali është në përputhje me standardet e OSBE-së për monitorimin e drejtësisë administrative dhe është përdorur për të udhëhequr monitorët e IKD-së, secili ka marrë trajnim të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës së monitorimit.³

b) Mbledhja e të dhënave

Gjatë periudhës nga 1 shkurt deri më 30 prill 2017, monitoruesit e IKD-së kanë monitoruar seanca gjyqësore në gjykatë duke u bazuar në udhëzimet e manualit, ata kanë monitoruar gjithsej 86 seanca dhe të gjitha seancat janë të raportuar në ueb faqen “Betimi për Drejtësi”⁴.

² Shënim: IKD kërkoj qasje në 40 vendime përfundimtare në rastet administrative që janë vendosur në vitin 2014, 2015 dhe 2016. Gjykata iu përgjigj pozitivisht kërkesës së IKD-së dhe siguroi qasje në 40 rastet e kërkuara. Përzgjedhja e rasteve është bërë nga stafi i gjykatës

³ Shënim: IKD gjatë hartimit të manualit bazohet në praktikën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në lidhje me monitorimin e seancave gjyqësore.

⁴ “Betimi për Drejtësi”: <http://betimiperdrejtesi.com/>.

IKD me 18 prill 2017, ka organizuar fokus grup me gjykatës të departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës Supreme, përfaqësues të institucioneve si Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, organizata jo-qeveritare që monitorojnë drejtësinë administrative etj. Në këtë fokus grup janë diskutuar gjetjet e monitorimit, duke përfshirë diskutim lidhur me gjendjen aktuale dhe zbatimin në praktikë të drejtësisë administrative.

Përmes intervistave të realizuara nga IKD me 6 gjykatës në departamentin administrativ dhe 4 gjykatës në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, janë mbledhur të dhëna lidhur me numrin e lëndëve në punë, pengesat dhe sfidat që ballafaqohen ata me këto lëndë gjatë procesit të punës.

III. Korniza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka materializuar standardet më të larta në lidhje me garancinë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut⁵.

Përderisa legjislacioni i aplikueshëm në drejtësinë administrative përmban disa mospërputhje të dispozitave ligjore të LKA-së dhe LPPA-së, që po ashtu nuk sigurojnë zbatim efikas të procedurës administrative nga ana e gjykatës dhe me këtë edhe të mbrojtjes së të drejtave të individëve⁶.

Po ashtu shumë shkallshmëria e mundësive të ankimit (në gjyqësor e po ashtu edhe në organet administrative) ndikon negativisht në efikasitetin e procedurave në kontestet administrative. Sipas Ligjit për Shërbyesit Civil, ekzistojnë dy mundësi të ankimit brenda administratës në rastet e rekrutimit, masave disiplinore dhe largimeve nga puna. Shkalla e fundit në kuadër të administratës është Bordi i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, kundër vendimeve të të cilit mund të bëhet ankesë në gjykatë (e cila përbëhet nga tri shkallë e së bashku me organin i cili e ka marrë vendimin fillestar, janë gjithsejtë gjashtë shkallë që mund të trajtojnë një kontest administrativ para se ta arrihet vendimi përfundimtar. E njëjta qasje vlen pothuajse të të gjitha organet tjera administrative⁷.

⁵ Kushtetuta e Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme, dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në këtë Kushtetutë. Gjithkush ka për detyrë të respektoj të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve. Për me tepër në nenin 22 të saj, Kushtetuta ka listuar instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat aplikohen drejtpërdrejtë në Kosovë.

⁶Të gjeturat nga fokus grupi i mbajtur me 18 maj 2017 me Gjyqtarë të Gjykatës Supreme, Departamenti Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ombudspersoni, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Oda e Avokatëve të Kosovës, shoqëria civile që monitorojnë drejtësinë.

⁷ Të gjeturat nga fokus grupi I mbajtur me 18 maj 2017.

a) Drejtësia administrative në Kushtetutën dhe Ligjin e Kosovës

Neni 32 i Kushtetutës së Kosovës garanton të drejtën e mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që shkelin të drejtat ose interesat e qytetarëve të saj⁸. Kushtetuta gjithashtu ka vendosur si kriter se mjetet juridike, përveç që janë në dispozicion, gjithashtu duhet të jenë efektive⁹.

Neni 13 i Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative¹⁰ (Ligji për PPA) garanton të drejtën e mjeteve juridike (mjetet administrative dhe juridike) kundër një veprimi administrativ ose mosveprimi të një autoriteti publik që shkel të drejtën e një personi ose interesin ligjor¹¹.

Ligji për Konfliktet Administrative (LKA)¹² rregullon kompetencat, përbërjen e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat ligjore të personave fizik dhe juridik dhe palëve të tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative. Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave ligjore të personave fizik, juridik, dhe të tjerë, të drejtat dhe interesat e të cilëve janë shkelur me vendime individuale ose veprime të organeve të administratës publike.

Sipas LKA, në një çështje të caktuar gjykata mund të vendosë të anulojë aktin e kontestuar administrativ dhe organi administrativ obligohet të veprojë ashtu siç është përcaktuar në aktgjykim dhe të nxjerr një akt të ri administrativ¹³.

Kurse neni 43 paragrafi 1 i LKA-së përcakton se “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”. Sipas paragrafit 2 i këtij neni kërkon nga gjykatës se e njëjta “konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me

⁸ Neni 32 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, e gjetur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> (tash e tutje: Kushtetuta).

⁹ Neni 54 e Kushtetutës.

¹⁰ Ligji Nr. 05/L-0-131 mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 20/21 qershor 2016, Prishtinë, gjetur në: <http://map.rks-gov.net/getattachment/beba5693-99b9-4c04-869a-50bbc431dc26/LIGJI-PER-PROCEDUREN-E-PERGJITHSHME-ADMINISTRATIVE.aspx> (tash e tutje: Ligji mbi PPA).

¹¹ Neni 13 e Ligjit mbi PPA.

¹² LIGJI Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 82 / 21 tetor 2010 në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707> (në vazhdim LKA).

¹³ Neni 43, paragrafi 2, LKA.

aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrative”

Paragrafi 3 i nenit 43 të LKA-së po ashtu parasheh që “gjkata mund të vërtetojë gjendjen faktike dhe në bazë të gjendjes faktike nxjerr aktgjykim, respektivisht vendim në baza meritore nëse plotësohen ndonjëra prej kushteve të mëposhtme:

- nëse anulimi i një akti administrativ dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili vështirë do të riparohet;
- nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative;
- nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit”¹⁴.

Për më tepër, sipas nenit 67 të LKA "nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nxjerr akt administrativ në kundërshtim me aspektet gjyqësore ose në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, ndërsa paditësi paraqet kërkesë të re, gjykata anulon aktin e kontestuar dhe si rregull, gjykata vendos me aktgjykim mbi çështjen. Ky vendim do të zëvendësojë aktin e organit kompetent "

Neni 65 i LKA-së obligon organet administrative për të zbatuar vendimet gjyqësore. Në mënyrë të ngjashme, neni 147 i Ligjit për PPA-në gjithashtu e detyron autoritetin administrativ të ekzekutojë aktin e ndryshuar ose të zëvendësohet nga gjykata¹⁵.

IKD ka monitoruar aplikimin e këtyre dy dispozitave në veçanti nga ana e gjykatës, pasi që Avokati i Popullit në një raport të publikuar në vitin e kaluar¹⁶, kishte tërhequr vëmendjen e IKD-së për një numër të madh të rasteve me të cilat organet administrative dhe gjykata krijojnë efektin e ashtuquajtur “ping-pong”. Sipas raportit të Ombudspersonit gjykatat nuk janë duke vendosur mbi bazueshmërinë e rastit dhe për të vlerësuar nëse ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 43 par. 3 është plotësuar. Ndërsa organet administrative nuk e zbatojnë vendimin e gjykatës siç parashihet me nenin 147 të PPA-së dhe nenin 65 të LKA-së, duke marrë kështu vendimin e njëjtë për herë të dytë.

Bazuar në analizën e IKD-së për LKA-në, nuk ka rregullore të dispozitave procedurale të procedurës ankimore. Neni 63 i LKA-së i referohet zbatimit të Ligjit për Procedurën Kontestimore në rastet kur LKA hesht për disa aspekte procedurale¹⁷. Neni 63 është përdorur

¹⁴ Neni 43, paragrafi 3, LKA.

¹⁵ Neni 147, paragrafi 1, PPA.

¹⁶ Institucioni i Avokatit të Popullit: Raport me Rekomandime: Prek Krasniqi ankesa nr. 72/2015 lidhur me mungesën e mjeteve juridike efektive, në: http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/1072-2016,_Raport_me_rekomandime_680722.pdf

¹⁷ Neni 63, LKA

nga gjykata në të gjitha vendimet përfundimtare të analizuara nga IKD. LKA-ja është miratuar para se të formohet Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në atë kohë kontestet administrative janë trajtuar nga Gjykata Supreme. Gjykata Supreme nuk kishte tre nivele të procedurës së ankesës siç është aktualisht e rregulluar dhe LKA nuk ka ndryshuar në përputhje me rrethanat

Siç do të theksohet më poshtë, gjetjet e IKD-së konfirmojnë të njëjtën gjë. Këto çështje të identifikuar nga monitorimi i IKD-ja janë miratuar edhe nga akterët e sektorit të drejtësisë, të cilët theksojnë që legjislacioni i aplikueshëm është pengesë për drejtësi efektive administrative dhe respektim të të drejtave dhe interesave të palëve në procedure¹⁸.

Edhe pse IKD nuk ka monitoruar organet administrative, problemi duket se ka rrënjë veçanërisht në fazën ku organet administrative vendosin për një çështje administrative ose duhet të veprojnë sipas vendimit të gjykatës për të ndryshuar vendimin e tyre fillestar. Megjithatë, personeli që punon në organet administrative është trajnuar në lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative¹⁹.

b) Mjetet Efektive Juridike: Konventat Ndërkombëtare dhe zbatimi në praktikë

Kushtetuta e Kosovës përcakton se marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe normat ligjore detyruese të së drejtës ndërkombëtare kanë përparësi mbi ligjet e Republikës së Kosovës.²⁰

Për më tepër, Neni 53 i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo dispozitë i detyron gjykatat në Kosovë të zbatojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kur vendosin për çështje administrative.

Në këtë aspekt, neni 13 i kësaj Konvente garanton të drejtën për një mjet efektiv juridik, domethënë kujtdo që i është shkelur e drejta dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën për një zgjidhje efektive përpara një organi kombëtar, pavarësisht nëse vepra kryhet nga persona që veprojnë në përmbushjen e funksioneve të tyre zyrtare.

¹⁸ Të gjeturat nga fokus grupi i mbajtur me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ombudspersoni, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Shoqata e Avokatëve të Kosovës, akterët e shoqërisë civile që monitorojnë drejtësinë administrative në Kosovë më 18 maj 2017.

¹⁹ *Ibid.*

²⁰ Neni 22 i Kushtetutës i është nënshtruar detyrimeve të njëanshme në zbatimin direkt të Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare. Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të mëposhtme janë të garantuara me këtë Kushtetutë, aplikohen direkt në Republikën e Kosovës dhe kanë përparësi në rast konflikti ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, duke përfshirë dhe pa u kufizuar në instrumentet ndërkombëtare siç janë: (1) Deklarata Universale e të drejtave të njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj

“Zgjidhje Efektive” do të thotë mekanizëm i duhur dhe funksional gjyqësor dhe administrativ për të trajtuar dhe vendosur mbi pretendimet për shkelje sipas ligjit vendas. Ky parim zbatohet dhe për shkeljet e kryera nga persona zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar të sigurojnë se çdo person ka të drejtë për zgjidhje efektive për shkeljet e të drejtave të tij/saj dhe t’u sigurohet individëve e drejta për t’iu drejtuar organeve ekzekutive, legjislative, gjyqësore dhe administrative²¹.

Zgjidhjet efektive nuk mund të konsiderohen të tilla kur janë një iluzion për shkak të kushteve të përgjithshme në vend, kur janë shumë të mundimshme për personin, të cilit i janë shkelur ose kur shteti nuk siguron zbatimin e duhur të tyre nga autoritetet gjyqësore. Gjithashtu, nëse një gjykatë refuzon të shqyrtojë çështjet substanciale në lidhje me një veprim administrativ të një organi ekzekutiv të cilin e konsideron se po ushtron detyrat e tij, apelimi s’mund të konsiderohet si zgjidhje efektive²².

IV. Rezultatet dhe të gjeturat

a) Struktura e Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka gjithsej 7 gjyqtarë, nga të cilët një është Udhëheqës i Departamentit dhe dy gjyqtarë janë ekskluzivisht për divizionin fiskal. Departamenti Administrativ deri në fund të janarit 2017 kishte 5800 raste në punë²³. Raporti Vjetor i KGJK-se për vitin 2016, tregon se deri në fund të vitit 2016 ka pasur 5192 raste të pazgjidhura që nënkupton 742 raste për gjyqtar dhe nëse merren parasysh të dhënat në fund të janarit me 5800 raste në punë rezulton se çdo gjykatës në këtë departament ka nga 825 raste në punë.

Ngarkesa me lëndë në Departamentin Administrativ e bën të vështirë për gjyqtarët që të trajtojnë rastet në kohën e duhur, në mënyrë që palët të marrin drejtësi. Departamenti administrativ ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës për të trajtuar lëndët, duke përfshirë mungesën e stafit profesional që ka ekspertizë në trajtimin e çështjeve në lidhje me çështjet doganore, administratën tatimore dhe të drejtat e pensioneve. Gjithashtu, gjyqtarët marrin një numër të madh masash të përkohshme që ndikon në trajtimin e lëndëve të tjera. Për më tepër, ky departament është përgjithësisht i ri dhe ende nuk ka zhvilluar ndonjë praktikë²⁴.

²¹ Doracaku për Monitorimin e Drejtësisë Administrative, Tirana, shkurt 2015, faqja 48:
<http://www.osce.org/sq/albania/165886?doenload=true>.

²² Ibid, faqja 49.

²³ Intervistë me kryesuesen e Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – gjykatësen - znj. Delushe Halimi

²⁴ Të gjeturat nga fokus grupi i mbajtur me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ombudspersoni, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas,

Rritja e numrit të rasteve të zgjidhura në departamentin administrativ gjatë vitit 2016 në 2404 lëndë, nga 959 lëndë e zgjidhura gjatë vitit 2015, i atribuohet rritjes së numrit të gjyqtarëve në këtë departament, nga dy gjyqtarë në vitin 2015, deri në shtatë gjyqtarë në 2016.


Lëndë Administrative	Nr. Lëndë të pazgjidhura në 01.01	Nr. Lëndë të pranuar	Nr. Lëndë të zgjidhura	Nr. Lëndë të pazgjidhura në 31.12	Shkalla e spastrimit - NP (%)	Koha e zgjidhjes - KZ (në ditë)
2014	2601	2568	1130	4039	44%	1,304
2015	4039	2300	959	5380	42%	2,047
2016	5380	2216	2404	5192	108%	788

Tabela 1 – Statistikat për numrin e lëndëve në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë

Tabela 1 tregon një rritje të dukshme të shkallës së spastrimit të lëndëve administrative nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Siç shihet më lartë ky departament në vitin 2014 dhe 2015 nuk ishin edhe efikas në zgjidhjen e lëndëve, kjo për arsye se në atë kohë kanë qenë vetëm 3 gjyqtare dhe nuk ka pasur divizion fiskal. Në fund të vitit 2015 dhe në fillim të vitit 2016, është shtuar numri i gjyqtarëve (tani gjithsej 7) të cilët merren me çështje administrative si dhe është implementuar funksionimi i divizionit fiskal, ku nga 7 gjyqtarë, dy (2) ekskluzivisht merren me çështje fiskale.

b) Të gjeturat nga monitorimi i seancave gjyqësore

IKD në fillim të çdo muaji ka pranuar nga Departamenti, numrin e seancave gjyqësore të caktuara nga gjykatësit për muajin respektiv. Departamenti Administrativ gjatë muajve shkurt, mars dhe prill kishte planifikuar mbajtjen e 433²⁵ seancave gjyqësore (shih grafikun 1). Monitoruesit e terrenit të IKD-së kanë monitoruar gjithsej 75 seanca nga 1 shkurti deri më 1 prill 2017. Nga 75 seancat e monitoruara, 47 janë mbajtur, ndërsa 28 janë shtyrë për datat e mëvonshme (shih tabelën 2).



Grafiku 1 – Numri i seancave të caktuara në Departamentin Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

IKD gjatë monitorimit të caktimit të seancave gjyqësore ka gjetur se jo të gjithë gjykatësit janë efikas në caktimin e seancave gjyqësore. Përderisa, gjykatës të caktuar brenda një muaji caktojnë deri në 33 seanca gjyqësore, ka gjykatës që caktojnë në raste të caktuara vetëm 5 seanca përgjatë një muaji. Tabela më poshtë pasqyron numrin e seancave të caktuara nga çdo gjykatës gjatë muajve shkurt, mars dhe prill 2017²⁶.

²⁵ Shënim: Kjo informatë statistikore bazohet në të dhënat e ofruara nga të gjithë gjyqtarët e departamentit administrativ lidhur me numrin e seancave të planifikuara për muajin përkatës, si dhe në bazë të procesit të monitorimit nga monitoruesit e IKD-së.

²⁶ Të dhënat e lartpërmendura janë siguruar nga gjykatësit në fund të çdo muaji, për muajin paraardhës.

<i>Gjykatësi</i>	<i>Shkurt</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Total</i>	<i>Mesatarja për muaj</i>
<i>1</i>	33	0 ²⁷	0	33	33
<i>2</i>	19	24	19	62	20.66
<i>3</i>	32	32	28	92	30.66
<i>4</i>	15	22	5	42	14
<i>5</i>	21	22	27	70	23.33
<i>6</i>	24	21	22	67	22.33
<i>7</i>	20	21	26	67	22.33

Tabela 2 – Numri i seancave të caktuara nga secili gjyqtarë në bazë mujore.

Numri më i madh i rasteve të monitoruara nga IKD, ka përfshirë lëndët ku kanë qenë të paditura, organet administrative, si Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës (KPMSSHCK), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), Doganat e Kosovës (DK), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), etj. Tabela më poshtë paraqet 10 organet administrative që më së shumti janë parashtruar padi kundër tyre gjate muajit shkurt, mars dhe prill 2017.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Shkurt	Mars	Prill	Total
1.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	60	46	36	142
2.	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës	19	15	4	38
3.	Doganat e Kosovës	36	33	36	105
4.	Administrata Tatimore e Kosovës	7	9	13	29
5.	Agjencia Anti-Korrupsion	4	6	4	14
6.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	5	2	1	8
7.	Organi Shqyrtues i Prokurimit	3	9	4	16

²⁷ Gjykatësi 1 nga muaji mars dhe prill 2017, është në pushim të lehonisë.

8.	Komunat	4	5	3	12
9.	Ministria e Shëndetësisë	2	3		5
10.	Ministria e Punëve të Brendshëm	3	6	6	15


Tabela 3 – Statistikat në lidhje me kërkesat e paraqitura kundër organeve administrative në baza mujore (shkurt, mars, prill 2017).

Një gjetje interesante ishte se në rastet kur qytetarët ngritën padi kundër MPMS, rastet në fjalë kanë të bëjnë me personat që kërkojnë të drejta për pension.

Periudha monitoruese	Numri i seancave të caktuara	Numri i seancave të mbajtura	Numri i seancave të shtyra
Shkurt	34	22	12
Mars	20	17	3
Prill	21	8	3
Total	75	47	28


Tabela 4 – Seancat e monitoruara nga IKD (shkurt, mars, prill 2017).

Prej këtyre rasteve të monitoruara, monitoruesit IKD-së kanë qenë në gjendje të sigurojnë 43 aktgjykime përfundimtare. Sipas analizës së IKD-së në këto aktgjykime, rezultojnë se 10 lëndë janë dërguar për rivendosje/rishikim të organeve administrative, 26 lëndë janë refuzuar për shkak se nuk kanë pasur bazë ligjore, 5 lëndë janë aprovuar dhe zgjidhur në meritë dhe 2 lëndë janë pezulluar për shkak se paditësit kanë tërhequr padinë e tyre (shih grafikun 3).



Grafiku 3 – Rezultatet e seancave të monitoruara nga IKD (shkurt, mars, prill 2017).

Grafika më poshtë është një pasqyrim grafik i arsyeve të zakonshme për rastet e shtyra nga shkurti-prill. Arsyet e zakonshme të shtyrjes ishin për shkak se palët kërkuan shtyrjen, mungesës së autorizimit të avokatit nga ana e paditësit, caktimi i ekspertizës, mungesat e përfaqësuesve, rastet/rrethanat e veçanta, saktësia e padisë e kërkuar, adresave të gabuara, mungesës së dëshmisë lidhur me letërthirjen, dhe mungesës së dëshmive të mjaftueshme lidhur me lëndën.



Grafiku 4 – Arsyet e shtyrjes së seancave të monitoruara nga IKD (shkurt, mars, prill 2017).

Sipas analizës së IKD-së në këto aktgjykime, rezultojnë se 10 lëndë janë dërguar për rivendosje/rishikim të organeve administrative, 26 lëndë janë refuzuar për shkak se nuk kanë pasur bazë ligjore, 5 lëndë janë aprovuar dhe zgjidhur në meritë dhe 2 lëndë janë pezulluar për shkak se paditësit kanë tërhequr padinë e tyre. Gjykata në 26 raste ka hedhur poshtë kërkesën për shkak të mungesës së bazës ligjore. Mungesa e avokatëve ndikon gjithashtu në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore. Bazuar në intervistat me gjyqtarët, por edhe si rezultat i monitorimit të gjykatave, përfaqësimi nga një jo-avokat luan një rol të rëndësishëm në efikasitetin e gjykatës. Ndërsa në rastet kur palët përfaqësohen nga avokatët, ka pikëpyetje lidhur me cilësinë e përfaqësimit pasi që shumica e avokatëve nuk kanë ekspertizë dhe trajnim të posaçëm në fushën e çështjeve administrative²⁸.

²⁸ Të gjeturat nga fokus grupi i mbajtur me gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ombudspersoni, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Shoqata e Avokatëve të Kosovës, akterët e shoqërisë civile që monitorojnë drejtësinë administrative në Kosovë më 18 maj 2017.

c) Intervista me palët e interesit

Për qëllime të mbledhjes së të dhënave kuantitative, IKD ka zhvilluar katër pyetësorë për gjyqtarët e Departamenteve Administrative të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme dhe një pyetësori për paraqitësit ankesave.

1. Intervistat me gjyqtarë

IKD ka intervistuar 9 gjyqtarët e Departamenteve Administrative të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme të Kosovës. Në bazë të intervistave IKD ka kuptuar që gjyqtarët e Departamenteve Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë kanë në punë se paku 600 lëndë. Disa nga gjyqtarët kanë më shumë se 750 lëndë në punë.

Sipas gjyqtarëve, Ligji për Konfliktet Administrative nuk i lejon ata të marrin një vendim në meritë që nga momenti i paraqitjes së padisë. Për gjykatësit vet ligji i kufizon ata dhe i udhëzon që t'i dërgojnë lëndët për rivendosje tek organet administrative për t'i zbatuar vendimet e gjykatës.

Ky interpretim i ligjit është në kundërshtim me kuptimin aktual të nenit 43, paragrafi 3 të Ligjit mbi Konfliktet Administrative, i cili parasheh që gjykata mund të vendosë vetë gjendjen faktike dhe bazuar në atë situatë faktike mund të nxjerrë një aktgjykim mbi meritat nëse ndonjë nga kërkesat e mëposhtme janë plotësuar:

- nëse anulimi i një akti administrativ dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili vëstitur do të riparohej;
- nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative;
- nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit²⁹.

Kjo do të thotë që gjyqtarët asnjëherë nuk marrin parasysh në analizimin e rasteve veçmas, nëse ndonjë nga kushtet janë plotësuar, pa marrë parasysh a ka ardhur lënda për herë të parë apo të dytën në gjykatë.

Sipas gjyqtarëve, organet administrative rrallë zbatojnë vendimet e gjykatave për të ri-vendosur për çështjen sipas udhëzimeve të dhëna nga gjykata. Në vend të kësaj, në shumicën e rasteve organet administrative injorojnë vendimet e gjykatës dhe nxjerrin vendimin e njëjtë si herën e

²⁹ Neni 43, paragrafi 3, LKA.

parë. Prandaj, palët janë të detyruara të paraqesin një kërkesë të re për herë të dytë në gjykatë. Sipas gjyqtarëve, vetëm kur rastet të dalin në gjyq për herë të dytë, gjykata mund të vendosë në merit.

IKD ka hasur në praktikë edhe raste kur vet Gjykata Themelore nuk ka vendosur sipas vendimeve të Gjykatës Supreme. Më 15 janar 2016, në rastin SIGKOS ishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Kjo gjykatë me 10 tetor 2014, kishte vendosur të refuzojë kërkesë padinë. Pala kishte paraqitur ankesë në gjykatë të Apelit. Gjykata e Apelit më 11 qershor 2015, kishte refuzuar ankesën e paditësit. Paditësi ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, më 30 nëntor 2015, ka marr Aktgjykim përmes së cilit është pranuar kërkesa si e bazuar dhe lënda është kthyer në ri-shqyrtim në Gjykatën Themelore. Gjykata Themelore me 14 mars 2017 ka marr vendim me të cilin është refuzuar kërkesën ³⁰.

Koha e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve në Gjykatën e Apelit, nuk është më shumë se 6 muaj nga data kur lënda i caktohet një gjyqtari. Ndërkaq, periudha kohore nga momenti i paraqitjes së ankesës deri në momentin e vendosjes është rreth 9 muaj. Në vitin 2016, Gjykata e Apelit ka pranuar 436 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 426 lëndë. Bazuar në gjetjet e IKD-së, deri në fund të vitit 2016, 334 lëndë mbeten për t'u proceduar në Gjykatën e Apelit.

Sipas intervistës së kryer me gjykatësin e vetëm që merret me çështjet administrative në Gjykatën Supreme, ka rreth 55 raste me kërkesë për rishikim të jashtëzakonshëm dhe mbrojtje të ligjshmërisë. Për më tepër, Gjykatës Supreme i duhet jo më shumë se 3 muaj për të vendosur për një rast. Tutje, kjo gjykatë tashmë po shqyrton rastet nga viti 2017.

Ajo që është e dukshme nga të gjitha intervistat me gjykatësit është se nuk ekziston një mekanizëm e monitorimit të gjykatave për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Monitorimi bëhet vetëm nga OJQ-të dhe institucionet e tjera që monitorojnë punën e gjykatave.

2. Intervista me palë

IKD gjatë muajit prill ka zhvilluar 11 intervista me palët / paditësit që janë subjekt të procedurave administrative në departamentin administrativ. Në të gjitha intervistat me paditës, ata kanë pasur ankesa lidhur me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. Ku nga 11 të intervistuar 5 prej tyre kanë paraqitur padi në gjykatë në vitin 2015, katër prej tyre në vitin 2014 dhe dy prej tyre në vitin 2013. Procedurat gjyqësore në këto raste ende janë në proces e sipër.

3. Analiza e vendimeve të formës së prerë

³⁰ Raporti nga monitorimi i seancave të lëndës së SIGKOS, 14 March 2017, gjetur në: <http://betimiperdrejtesi.com/sigkos-kerkon-gjykata-te-vendose-bazuar-ne-vendimin-e-gjykates-supreme/>.

IKD në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, ka siguruar 40 vendime të formës së prerë nga Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Zgjidhja e 40 lëndëve është bërë sipas metodës së rastësisë, dhe ka përfshirë vendosjen e tyre nga gjykata gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016. IKD ka analizuar këto raste dhe rezultatet tregojnë që në shumicën e lëndëve, gjykata ka vendosur në favor të organit administrativ.

Nga dyzet (40) raste të analizuar, tetëmbëdhjetë (19) ishin në favor të organeve administrative, gjashtëmbëdhjetë (13) ishin në favor të paditësit dhe në gjashtë (8) raste paditësi tërhoqi padinë. Tabela nr 5 (shih më poshtë) tregon organet administrative të cilat kanë qenë palë në procedurë dhe ku gjykata ka vendosur në favor të tyre.

Organet Administrative	Numri i lëndëve
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	7
Administrata Tatimore e Kosovës	2
Komuna e Pejës	1
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës	3
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1
Instituti Gjyqësor i Kosovës	1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1
Oda e Avokatëve të Kosovës	1
TOTAL	19

Tabela 5 - organet administrative të cilat kanë qenë palë në procedurë dhe ku gjykata ka vendosur në favor të tyre

Në një rast paditësi kërkoi që çështja të pezullohej sepse kishte kaluar shumë kohë që nga paraqitja e padisë dhe nuk kanë më interes ligjor për të vazhduar me rastin. Në këtë rast, paditësi ka paditur Kuvendin Komunal të Gjilanit - Departamentin e Arsimit, për përzgjedhjen e një kandidati për pozitën e 'sekretarit' të një shkolle fillore. Kjo ankesë ishte parashtruar më 28 shkurt 2011 dhe fillimisht ishte refuzuar nga Departamenti i ankesave brenda Komunës. I pakënaqur me refuzimin e ankesës, paditësi bëri një ankesë të dytë më 8 prill 2011 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilët pjesërisht e pranuan ankesën më 11 maj 2011, ku ata morën vendim për anulimin e konkursit. Më 17 qershor 2011, paditësi pastaj e paditi Kuvendin Komunal në Gjykatën Komunale në Gjilan.

U deshën të kalojnë katër vite, më 12 qershor 2015, që Gjykata Themelore e Gjilanit - Departamenti i Përgjithshëm deklaroi se nuk ishte kompetente për të trajtuar këtë rast dhe e dërgoi çështjen në Departamentin Administrativ në Prishtinë. Më 13 nëntor 2015, paditësi paraqiti një padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës - Departamenti Administrativ. Më 6

qershor 2016 paditësi e njoftoi Gjykatën se dëshiron ta tërheqë padinë. Më në fund, më 8 qershor, Gjykata mori vendim për pezullimin e çështjes. Në këtë rast të veçantë që nga ankesa fillestare deri në zgjidhjen përfundimtare u deshën 5 vjet dhe 5 muaj për të u vendosur, respektivisht nga 28 shkurti 2011 deri më 8 qershor 2016.

Në shumicën e vendeve të BE-së koha e llogaritur për zgjidhjen e lëndëve varion në disa muaj, për shembull në Slloveni ajo është 112 ditë, në Suedi 114 ditë³¹.

V. Konkluzionet

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se pavarësisht nga një kornizë relativisht e mirë ligjore dhe mekanizmat për administrimin e drejtësisë administrative, qytetarët e Kosovës përballen me mungesë të qasjes efektive dhe efikase në drejtësinë administrative.

Vështirësitë që Departamenti Administrativ ka me staf mbështetës të pamjaftueshëm, gjyqtarë të pamjaftueshëm dhe ngarkesa e lëndëve janë më se të dukshme. Megjithatë, IKD ka gjetur se gjyqtarët kanë krijuar një praktikë të keqe duke dërguar çdo rast që ata marrin për ri-shqyrtim tek organet administrative, pa vlerësuar vet rastin nëse janë përmbushur ndonjë rrethanë e paraparë në paragrafin 3 të nenit 43 të LKA-së. Nëse gjyqtarët do të analizonin çdo rast në dritën e paragrafit 3 të nenit 43 të LKA-së, të paktën në disa nga rastet, ata do të ishin në gjendje të vendosnin në bazë të meritave dhe të mos e dërgonin çështjen për ri-shqyrtim në organet administrative. Kjo praktikë do të sigurojë jo vetëm mjete efektiv juridike për palët, por gjithashtu do të kontribuonte si një mjet "edukimi" për organet administrative.

Raporti gjithashtu konfirmon faktin se organet administrative nuk zbatojnë vendimet gjyqësore, duke injoruar Ligjin për Konfliktin Administrativ dhe Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili i obligon ata ta bëjnë këtë. Nga ana tjetër, gjykatat nuk përdorin mekanizma të parashikuara në ligj (neni 68 i LKA) për të monitoruar zbatimin e vendimeve të tyre nga organet administrative.

Ndërsa shqetësimi më i ngushtë është e ashtuquajtura efekt ping-pong që organet administrative dhe gjykatat krijojnë kur merren me lëndët, të dhënat e IKD-së gjithashtu tregojnë se ka nevojë për ndryshime të mëdha në Ligjin për Konflikte Administrativ, shumica e seancave gjyqësore anulohen dhe se gjyqtarët, stafi i gjykatës dhe avokatët nuk kanë ekspertizën e duhur për procedurën administrative.

Të gjitha këto çështje potencialisht mund të jenë subjekt i monitorimit të veçantë nga OSHC-të, institucionet gjyqësore dhe vendimmarrësit. Ky raport është një nga shumë pak iniciativa serioze të përqendruara për të monitoruar Drejtësinë Administrative. IKD-ja ka identifikuar se ka nevojë

³¹ Sipas tabelës së BE-së për Rezultatet në Drejtësi 2016: http://ec.europa.eu/justice/effective-justice/files/justice_scoreboard_2016_en.pdf

për monitorime dhe raporte të ngjashme të ngjashme që kontribuojnë në përmirësimin e drejtësisë administrative në Kosovë.

VI. Rekomandimet

- Të gjitha aketët relevant duhet të fillojnë të diskutojnë lidhur me nevojën për një reformë të përgjithshme në drejtësinë administrative në Kosovë.;
- Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Administratës Publike duhet të iniciojnë ndryshimin e Ligjit mbi Konfliktin Administrativ me qëllim të sigurimit të mjeteve efektive juridike dhe të drejtave të individëve nga:
 - Vendosja e një mandati të qartë të gjykatës dhe detyrimi për të konstatuar të gjitha faktet e çështjes gjatë procedurës (me iniciativën e vet) me qëllim të marrjes së vendimeve meritore në të gjitha rastet;
 - Vendosja e mandatit të gjykatës për shqiptimin e gjobave për organet administrative që nuk zbatojnë vendimet gjyqësore, veçanërisht kreun e organit administrativ;
 - Përfshirja e dispozitave shtesë që rregullojnë çdo aspekt të Procedurës Kontestimore Administrative.
- Gjykatësit duhet të zbatojnë nenin 43 paragrafi 3 të Ligjit aktual mbi Procedurën Kontestimore dhe të rishikojnë çdo lëndë nëse ndonjë nga rrethanat e përcaktuara në këtë nen është plotësuar dhe të vendosë në bazë të meritës;
- Gjykatat duhet të zbatojnë nenin 68 të Ligjit aktual mbi Procedurën Kontestimore;
- Akademia e Drejtësisë duhet të organizojë trajnime të specializuara për gjyqtarët e Departamentit Administrativ dhe personelin mbështetës;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të rrisë numrin e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës (përfshirë këshilltarët ligjorë me përvojë në fushën administrative, fiskale dhe doganore) në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Asociacioni i Avokatëve të Kosovës si pjesë e programit të Edukimit Ligjor të Vazhduar duhet të trajnojë avokatët për procedurën e Kontesteve Administrative;
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike të organizojë trajnime për nëpunësit civilë lidhur me zbatimin e Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore;
- Organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe vendimmarrësit duhet të monitorojnë drejtësinë administrative në Kosovë dhe të japin rekomandime për përmirësim.